



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. _____

Datë:05.10.2017

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, mbështetur në nenin 28, nenin 29 paragrafi (1), nenin 54, paragrafi (2) me nën paragrafin 2.3, neni 3 paragrafi (1.8), neni 34, nenin 35 paragrafi (5) i Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr.88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë të dyshimeve për fiksime të çmimeve – marrëveshje e ndaluar në mes të floktarëve të Komunës së Lipjanit, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 05.10.2017 merr këtë:

K O N K L U Z I O N

- I. Bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun relevant, konstatohet se nuk ka argumente për Fillimin e Procedurës Hetimore në sektorin e ofrimit të shërbimeve të floktarëve në Komunën e Lipjanit, për arsye se marrëveshja nuk është zbatuar.
- II. Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, të monitoroj sjelljet e ndërmarrësve (floktarët) në tregun përkatës në Komunën e Lipjanit për një periudhë të pacaktuar kohore.

A R S Y E T I M

Autoritetit Kosovar të Konkurrencës sipas detyrës zyrtare me 12.06.2017, ka autorizuar inspektorët hetues që të inspektojnë tregun relevant lidhur me dyshimin për marrëveshje të ndaluar në mes të pronarëve (floktarëve) të ndërmarrjeve të cilët merren me (qethjen e flokëve, etj) kanë monitoruar tregun përkatës në komunën e Lipjanit.

Me këtë rast gjatë monitorimit dhe bisedës me disa nga pronarët e salloneve kemi gjetur se ata kanë ngritur çmimet për shërbimet e tyre përmes një marrëveshje. Për të ngritur çmimet për

shërbimet e tyre ata kanë arritur një marrëveshje të cilën e kanë nënshkruar gjithsejtë 18 pronar frizerë të Komunës së Lipjanit. Gjatë bisedës me ta pas kryerjes së inspektimit në disa sallone kemi arritur të gjejmë një kopje të kësaj marrëveshje për ngritjen e çmimit për shërbimet e tyre.

Përcaktimi i tregut përkatës

Tregu gjeografik - duke iu referuar *nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës nr. 02/2011*, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Komunës së Lipjanit.

Tregu i produktit:

1. *Qethja e kokës*
2. *Rruarja e kokës*
3. *Rruarja e fytyrës*
4. *Rruarja me makinë*
5. *Rruarja me dekorim*
6. *Larja e kokës*

Me datën 14.06.2017 Autoriteti ka pritur në takim pronarët e salloneve (floktarët) e Lipjanit – nënshkruer të marrëveshjes, të cilët kanë sjellur një akt shfuqizues jo formal të asaj marrëveshje të cilin akt e kanë nënshkruar me zotimin se e prishin (shfuqizojnë) këtë marrëveshje dhe se çmimet do të mbesin ata që kanë qenë para marrëveshjes.

Pronarët e ndërmarrjeve (floktarët) gjatë takimeve dhe bisedave kanë pranuar se kanë mbajtur një takim të përbashkët në mes tyre dhe aty kanë vendosur për ngritjen e çmimeve me marrëveshje për disa nga shërbimet që i ofrojnë për qytetarët në sallonet e tyre. Ata kanë deklaruar se arsyeja e ngritjes së çmimeve ka qenë ngritja e çmimeve furnizuese nga disa produkte që i shfrytëzojmë gjatë punës si dhe nga shkaku i ngritjes së qirasë, etj. Po ashtu ata kanë deklaruar se kemi ngritur çmimet me marrëveshje nga se nuk kemi pas njohuri për këtë veprim nëse është i ligjshëm apo jo. Ne kemi menduar se jemi duke vepruar mirë nga se disa flokëtar janë duke na dëmtuar duke i ngritur apo ulur çmimet për shërbimet e tyre dhe ne menduam të unifikojmë (fiksojmë) çmimet për shërbimet tona dhe më pastaj secili nga ne ta respektoj atë marrëveshje. Ne kemi menduar që marrëveshjen ta zbatojmë nga data 15.06.2017.

Gjatë monitorimit të tregut përkatës, mbledhjen e të dhënave dhe deklaratimet e pronarëve të floktarëve në Lipjan, kemi konstatuar se pronarët kanë arritur një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga 18 pronar (*e cila marrëveshje bie ndesh dhe është e ndaluar apo praktikë e bashkërenduar sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-229, për Mbrojtjen e Konkurrencës*), për rritjen e çmimeve 50-65% në produktet e cekura më lartë, mirëpo marrëveshja nuk është zbatuar meqenëse ata pronarë nënshkruer kishin caktuar datën 15 qershor 2017 si ditë të fillimit të zbatimit në praktikë të kësaj marrëveshje.

Gjatë monitorimit të tregut përkatës kemi vlerësuar se marrëveshja është bërë për shkak se pronarët nuk kanë pas njohuri mbi dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229, për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe me këtë rast kemi gjetur se kjo marrëveshje nuk është zbatuar, nuk ka pas impakte ekonomike në treg e as palë të dëmtuar.

Përfundimisht vlerësojmë se kjo marrëveshje është bërë nga mosnjohja e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për më shumë ajo nuk ka prodhuar ndonjë pasojë për palët e involvuara sikundër kësaj cilësojmë si një marrëveshje naive e cila nuk ka pasur ndikim apo efekte të çrregullimit të konkurrencës në treg.

Sipas evidencës së të dhënave dhe cilësimit të kësaj sjellje të ndërmarrësve në treg, aktivitetit dhe ndërhyrjes së inspektorëve në parandalim të zbatimit të sajë, *konstatojmë* se nuk ka interes publik për të filluar procedurë hetimore, andaj departamenti i mbikëqyrjes së tregut, obligohet që ta mbajë nën monitorim edhe për një periudhë të pacaktuar kohore për sjelljet e ndërmarrësve në tregun relevant.

**KOMISIONI
AUTORITETIT KOSOVAR I KONKURENCËS**

(_____)
Valon PRESTRESHI
Kryetar

(_____)
Ahmet KRASNIQI
Zv. Kryetar

(_____)
Fatime HAZIRI
Anëtare

(_____)
Muhamed KRASNIQI
Anëtar

(_____)
Shaqir MORINA
Anëtar

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- *Arhiva*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*
- *Palët*